

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P. Nr 170/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në trupin gjykues në përbërje nga gjyqtarja e EULEX-it Roxana Marilena Comsa si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fiser dhe gjyqtari vendor Rifat Bllata si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Chiara Tagliani si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër:

B. G., me pseudonimin T., shqiptar i Kosovës, në paraburgim nga 23 tetori 2012 deri më 13 gusht 2015;

Dhe

H. A., shqiptar i Kosovës, në paraburgim nga 06 dhjetori 2012 deri më 06 mars 2013;

Të dy të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të datës 27 dhjetor 2012, të ndryshuar më 16 janar 2013 dhe herën e dytë më 22 mars 2013 për veprat penale të:

“Krimi i organizuar” në kundërshtim me nenin 274 paragrafi (2) në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe “Kontrabandimi me migrantë” në kundërshtim me nenin 138 paragrafi (6) i lexuar me paragrafin (1) në lidhje me nenin 23 të KPK-së;

Pasi ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor, të gjitha të hapura për publikun, më 28 Shkurt 2017, 01, 08 dhe 14 Mars 2017, 14 Qershor 2017, 30 Gusht 2017, 06 Nëntor 2017, 18 Janar 2018 dhe 12 Mars 2018, në prani të të akuzuarit B. G. dhe mbrojtësit të tij K. O., të të akuzuarit H. A. dhe mbrojtësit të tij F. K., palëve të dëmtuara B. B. dhe F. H. (më 14 Mars 2017, 14 Qershor 2017, 30 Gusht 2017 dhe 06 Nëntor 2017) dhe F. H. (me 28 Shkurt 2017 dhe 01 Mars 2017) dhe të prokurorit të shtetit,

Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 12 Mars 2018;

Bazuar në nenin to 366 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP) më 14 Mars 2018 në seancë publike dhe në praninë e të dy të akuzuarve, mbrojtësve të tyre dhe të prokurorit të shtetit;

Merr këtë:

AKTGJYKIM

I. Të akuzuarit B. G. dhe H. A.

SHPALLEN FAJTORË

Sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se gjatë vitit 2011, të pandehurit B. G. dhe H. A., me qëllim të sigurimit të dobisë financiare në bashkëpunim me mbështetjen e shtetasve të Shqipërisë, vepruan qëllimisht me synimin e përbashkët që të lehtësonin transferimin e shtetasve të Kosovës në vendet e tjera evropiane në këmbim të parave, të dy duke qenë në dijeni se ata

persona nuk posedonin dokumente të vlefshme që do t'u mundësonin atyre t'i kalonin kufijtë e atyre vendeve në mënyrë të ligjshme, në mënyrë më specifike:

- Rreth gjysmës së dytë të vitit 2011, i pandehuri B. G. arriti një marrëveshje me F. B. në kuptimin që i pandehuri B. G. do të merrte 2.500 euro që ta dërgonte F. B. në Itali. Pas kësaj marrëveshje, të pandehurit G. dhe H. A. e transportuan F. B. për në D., Sh., së bashku me të afërmin e tij B. B., me anë të veturës së A., që e drejtonte ai. Në D., i pandehuri G. e vuri B. dhe F. B. në kontakt me dy shtetas të Sh. me qëllim të lehtësimit të udhëtimit të F. për në I. pa dokumente të duhura. Kur u kuptua se F. ishte i mitur, i pandehuri G. vendosi se nuk do ta dërgonte atë në I. përmes portit të D.. Të pandehurit B. G. dhe H. A. pastaj i dërguan B. dhe F. B. në T.. Në T., G. pati një takim tjetër me dy shtetas të Sh. ku u diskutua mundësia e dërgimit të F. në I. përmes G. për shumën prej 2.500 euro, por që kjo nuk u realizua asnjëherë. Pastaj B. dhe F. B. u kthyen në K. nga G. dhe A. në të njëjtën veturë që drejtohej nga ky i fundit;
- Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011, të pandehurit B. G. dhe H. A. i transportuan për në T., Sh., D. M. dhe F. H., shtetas të K. me një veturë që drejtohej nga H. A.. Në T., i pandehuri G. organizoi që D. M. dhe F. H. të takoheshin me një shtetas të Sh. i cili u siguroi atyre pasaporta biometrike të falsifikuara të R. së Sh.. D. M. dhe F. H. i dhanë 3500 € të pandehurit G. dhe D. M. ia dha edhe veturën e tij Volkswagen Golf. I pandehuri A. i transportoi M. dhe H. dhe i la ata afër kufirit me G., që ata pastaj e kaluan në këmbë. M. dhe H. pastaj e morën një traget nga G. për në I.. Me të arritur në Portin e B., I., ata u kapën nga policia italiane me pasaporta të falsifikuara dhe u kthyen në G. ku edhe u arrestuan, kaluan pesë javë burg dhe pastaj përmes IRJM-së u kthyen në K..
- Në të dyja herët, i pandehuri A. u shpërblye për shërbimet e tij të vozitjes.

Prandaj,

I akuzuari **B. G. DËNOHET** për kryerje të veprës penale ***“Kontrabandimi me migrantë”*** në kundërshtim me nenin 138 paragrafi (6), i lexuar me paragrafin 1, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në pajtim me nenin 2 (1) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës - Ligji 04 / L-082 (KPRK); *në këtë mënyrë u ricilësuan veprat penale fillestare* të Krimin të organizuar, në shkelje të nenit 274 paragrafi (1) të lexuar në lidhje me nenin 23 të Kodit të mëparshëm Penal të Kosovës dhe Kontrabandimi me migrantë, në kundërshtim me nenin 138 paragrafi (6), të lexuar me paragrafin (1), si dhe të lexuar në lidhje me nenin 23 të Kodit të mëparshëm Penal të Kosovës.

DHE

I akuzuari **H. A. DËNOHET** për kryerje të veprës penale ***“Kontrabandimi me migrantë”*** në kundërshtim me nenin 138 paragrafi (6), i lexuar me paragrafin 1, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në pajtim me nenin 2 (1) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës - Ligji 04 / L-082 (KPRK); *në këtë mënyrë u ricilësuan veprat penale fillestare* të Krimin të organizuar, në shkelje të nenit 274 paragrafi (1) të lexuar në lidhje me nenin 23 të Kodit të mëparshëm Penal të Kosovës dhe Kontrabandimit me migrantë, në kundërshtim me nenin 138 paragrafi (6), të lexuar me paragrafin (1), si dhe të lexuar në lidhje me nenin 23 të Kodit të mëparshëm Penal të Kosovës.

III. Rrjedhimisht i akuzuari B. G.

DËNOHET

me 4 (katër) vjet burgim në pajtim me nenet 38 (1) dhe 138 (6) të KPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim që nga 23 tetori 2012 deri më 13 gusht 2015 të përfshihet në dënimin me burgim në pajtim me nenin 73 paragrafët (1) dhe (4) të KPK-së.

IV. Rrjedhimisht i akuzuari H. A.

DËNOHET

me 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim në pajtim me nenet 38 (1) dhe 138 (6) të KPK-së.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 6 dhjetori 2012 deri më 6 mars 2013 të përfshihet në dënimin me burgim në pajtim me nenin 73 paragrafët (1) dhe (4) të KPK-së.

V. SHPENZIMET

Secili nga të akuzuarit paguan nga 200 (dyqind) euro si pjesë të shpenzimeve të procedurës penale, por lirohen nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të mbetura në pajtim me nenin 453 paragrafët (1) dhe (4) të KPP-së. Të akuzuarit e kompensojnë shumën e urdhëruar jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim merr formë të prerë.

ARSYETIM

A. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 27 dhjetor 2012, Prokurori Special i Republikës së Kosovës (Prokurori) paraqiti Aktakuzën PPS 07/12 kundër të pandehurve B. G. dhe H. A., ku të pandehurit B. G. dhe H. A. i akuzonte për veprat penale të 'Kontrabandimi me migrantë, në shkelje të nenit 138 paragrafi (6) i lexuar me paragrafin (1) në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe me veprën penale të 'Kriminaliteti i organizuar' në shkelje të nenit 274 paragrafi (2) i lexuar në lidhje me nenin 23 të KPK-së. Më vonë aktakuza u ndryshua më 16 janar 2013 dhe më 22 mars 2013. Pas ndryshimit të 22 marsit 2013, vepra penale e Kriminalitetit të organizuar u rikualifikohet si neni 274 paragrafi (1).
2. Më 22 mars 2013, ishte mbajtur shqyrtimi fillestar mbi aktakuzën sipas nenit 245 të KPP-së. Kundërshtimet ndaj provave të paraqitura në aktakuzë dhe kërkesa për hedhjen e aktakuzës ishin paraqitur nga të dy të pandehurit. Më 19 qershor 2013, kryetarja e trupit gjykues nxori një aktvendim, ku refuzonte kërkesat e mbrojtjes për hedhje të aktakuzës dhe e dërgoi çështjen për shqyrtim gjyqësor.
3. Dispozitivi i Aktgjykimit ishte shpallur në shqyrtimin gjyqësor të parë më 26 shtator 2013.
4. Më 13 gusht 2015, Gjykata e Apelit nxori një aktvendim në çështjen PAKR Nr. 193/2014 me të cilin ata e anuluan verdiktin e shkallës së parë dhe e dërguan çështjen në rigjykim.
5. Seancat e shqyrtimit gjyqësor aktual janë mbajtur më 28 shkurt, 1, 8 dhe 14 mars, 14 qershor, 30 gusht, 6 nëntor 2017, 18 janar dhe 12 mars 2018.

6. Në pajtim me nenin 541 të Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP), që ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013¹, shqyrtimi u krye sipas dispozitave të Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës (KPP).

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

7. Ligji për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199 (LGJ) po ashtu hyri plotësisht në fuqi më 1 janar 2013 (neni 43). Ky rregullon kompetencën territoriale dhe lëndore të gjykatës.
8. Sipas nenit 11 paragrafi (1) të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe
9. Në nenin 9 paragrafi (2) nën-paragrafi (2.7) të po të njëjtit Ligj thuhet se Gjykata Themelore e Mitrovicës themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, L., Z. P., Z., S. dhe V.. Bazuar në aktakuzën e paraqitur, veprat penale të pretenduara pjesërisht kanë ndodhur në S. dhe, rrjedhimisht, në kuadër të juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, sipas nenit 29 paragrafi (1) të KPP-së. Për më tepër, duke pasur parasysh se kërkesa për fillimin e procedurës së pari ishte paraqitur, në atë kohë, në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë², bazuar në nenin 29 paragrafi (2) të KPP-së, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka kompetencë mbi këtë lëndë.

¹ Ligji nr. 04/L-123 KODI I PROCEDURËS PENALE;

² Aktvendimi për fillimin e hetimeve i paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 23 shkurt 2012;

10. Sipas nenit 15 paragrafi (1) nën-paragrafët (1.15) dhe (1.18) të Ligjit për Gjykatat të cekur më lart, veprat penale 'Kontrabandimi me migrantë' dhe 'Krimi i organizuar' hyjnë në kuadër të kompetencave të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore.
11. Sipas paragrafit (2) të po të njëjtit nen dhe bazuar në Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë³, dhe në pajtueshmëri me Aktvendimin e Ushtruesit të detyrës të Kryetarit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës⁴, lënda ishte shqyrtuar nga një trup gjykues në përbërje nga gjyqtarja e EULEX-it Roxana Marilena Comsa si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fiser dhe gjyqtari vendor Rifat Bllata si anëtarë të trupit gjykues. Asnjëra nga palët nuk e kishte kundërshtuar kompetencën e Gjykatës ose përbërjen e trupit gjykues.

C. SHQYRTIMI GJYQËSOR

12. Seancat e shqyrtimit gjyqësor kanë qenë të hapura për publikun dhe u mbajtën më 28 shkurt 2017, 1 mars 2017, 8 mars 2017, 14 mars 2017, 14 qershor 2017, 30 gusht 2017, 6 nëntor 2017, 18 janar 2018 dhe 12 mars 2018.
13. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të 28 shkurtit 2017, të dy të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm për të dyja akuzat.
14. Pala e dëmtuar B. B. ishte i pranishëm gjatë seancave më 14 mars 2017, 14 qershor 2017, 30 gusht 2017 dhe 6 nëntor 2017 dhe pala e dëmtuar F. H. mori pjesë në seancën e 1 marsit 2017.

³ Ligji nr. 03/L-053;

⁴ Aktvendimi GJA 127/16 i datës 12 Prill 2016

D. PROCEDURA E PARAQITJES SË PROVAVE

i) Provat e paraqitura gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor

15. Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar këta dëshmitarë:

- B. B. (i thirrur si palë e dëmtuar dhe si dëshmitar nga prokuroria) u dëgjua më 14 qershor 2017 dhe 30 gusht 2017;
- F. H. (i thirrur si palë e dëmtuar dhe si dëshmitar nga prokuroria) u dëgjua më 1 mars 2017;
- S. H. (dëshmitare fillimisht e propozuar nga prokurori) nuk u thirr më pasi që palët u pajtuan që deklaratën e saj të mëparshme ta konsiderojnë si të lexuar në seancë më 1 mars 2017;

16. Gjatë seancës së shqyrtimit të 6 nëntor 2017, palët u pajtuan që ta konsiderojnë të lexuar procesverbalin e 23 shtatorit 2013, kur prokurori solli si provë dokumentet e mëposhtme të renditura më poshtë⁵:

- Procesverbal i marrjes në pyetje të të pandehurit B. G. (lidhja 5);
- Procesverbal i seancës së marrjes në pyetje të dyshuarit H. A. (lidhja 6);
- Raportet e përgjimit në lidhje me telefonin e të pandehurit B. G. (lidhja 7);
- Raportet e përgjimit në lidhje me N. B. (lidhja 8);
- Një CD me referencë në sendet e kapura gjatë kontrollit (lidhja 9);
- Raport përmbledhës i SMS-ve hyrës/dalës për numrat e G. (lidhja 10);
- Raporti mbi publikimin e të dhënave financiare, që u referohet xhirollogarive bankare të B. G. dhe H. A. (lidhja 12);

⁵ Shih Regjistratori i Prokurorisë #1;

- Një raport tjetër përmbledhës mbi publikimin e të dhënave financiare, që nënvizon veturat që u atribuohen të pandehurve (lidhja 13, faqet 226 -233 të versionit në anglisht, faqet 237- 246 të versionit në shqip);
- Raportet e kontrolleve dhe vërtetimet e konfiskimit (lidhjet 14 dhe 15).

17. Sa u përket sendeve të kapura dhe të përfshira në CD, ato janë paraqitur si prova materiale, si vijon:

- Tri (3) pasaporta, prova materiale 1;
- Dy kartela identifikimi të G., patentë shoferi dhe kartela e identifikimit, prova materiale 2;
- Dokumenti me informata se si të aplikohet për vizë, prova materiale 3;
- Dëftesa e P. C. Bank mbi paratë e pranuar, prova materiale 4;
- Kutia e kartelës Vala dhe kartela e B., prova materiale 5;
- Një copë letër me informatat përkitazi me dokumentet e kërkuara për punësim në Gj., prova materiale 6;
- Një copë letër me një adresë në P., prova materiale 7;
- Formulari i aplikimit për Vizën Schengen, prova materiale 8;
- Notesi i adresave, prova materiale 9;
- Copë letre ku raportohet data '14 nëntor 2011' dhe emri i 'Qafa Restorant Dora';
- Copë të tjera letre me numra mbi të.

18. Gjatë seancës së njëjtë të shqyrtimit të 23 shtatorit 2013, mbrojtësi i të pandehurit B. G., avokati K. O. e paraqiti provën e mëposhtme:

- Raporti i shtrimit në spital të të xhaxhait të B. G. (H. G.), prova materiale 12.

Duke u pajtuar që të lexohen në procesverbalin e tanishëm, të procesverbalit të seancës së 23 shtatorit 2013, dokumenti në fjalë po ashtu bëhet pjesë e materialit si provë.

19. Në seancën e 6 nëntorit 2017, të pandehurit B. G. dhe H. A. deklaruan se ata qëndronin prapa deklaratave të tyre të dhëna në seancën e shqyrtimit të parë gjyqësor të 23 shtatorit 2013.

ii) Propozimet

- *Kërkesa për të thirrur të dyshuarit R. D. dhe C. D. nga Sh.*

20. Gjatë seancës së shqyrtimit të 1 marsit 2017, mbrojtësi K. O. paraqiti propozimin për marrjen në pyetje të dy të dyshuarve të përmendur për të cilët në aktakuzë thuhet se kanë vepruar në bashkë-kryerje me të dy të akuzuarit në kryerjen e veprave penale me të cilat ata ngarkohen. Mbrojtësi e paraqiti këtë propozim me qëllim të sqarimit të shumës së parave që siç pretendohet i janë paguar të pandehurit G..

21. Propozimi u refuzua sipas nenit 128 (1) (1.1) si i papranueshëm – pasi që ai ishte në kundërshtim me nenin 126 (1.3) të KPP-së; përveç tjerash, sipas nenit 258 (2)(2.3) të KPP-së, propozimi u vlerësua të jetë tërësisht i paarritshëm⁶.

- *Kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë (NJN) për D. M.*

22. Gjatë seancës së shqyrtimit të datës 28 shkurt 2017, prokurori paraqiti kërkesën që ta dëgjojë dëshmitarin D. M. drejtpërdrejt, që besohet se aktualisht jeton në Gj. pasi që dëshmitari i përmendur nuk mund të gjendej në K..

⁶ Shih Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 8 mars 2017

23. Përmes kërkesës për Ndhimë Juridike të Ndërsjellë trupi gjykues ka kërkuar nga autoritetet gj. që të japin çfarëdo informata të dobishme për identifikimin e vendndodhjes së këtij dëshmitari. Autoritetet gj. nuk kanë mundur të ofrojnë informata të tilla⁷. Propozimi për të thirrur dëshmitarin u refuzua sipas nenit 258 (2) (2.3) të KPP-së si tërësisht e paarritshme⁸.

- *Pranueshmëria dhe shfrytëzimi i deklaratës së dhënë nga D. M.*

24. U vendos po ashtu që në bazë të nenit 123 të KPP-së, deklarata e dhënë nga D. M. në fazën e hetimeve nuk mund të paraqesë provë të drejtpërdrejtë në këtë rast.⁹

E. GJETJET FAKTIKE

E.1. Përmbledhje e fakteve të vërtetuara

25. Gjykata duhet të përcaktojë se cilat janë faktet e vërtetuara mbi bazën e provave të administruara të dorëzuara kundër të akuzuarve B. G. dhe H. A. për veprat penale 'Kontrabandimi me migrantë' dhe 'Krimi i organizuar'.

26. Pasi provat e pranueshme u paraqitën dhe u administruan gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, Gjykata i konsideroi faktet relevante të mëposhtme si të vërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm:

- I. I pandehuri B. G. njihej si person i cili mund të lehtësonte lëvizjen e individëve për në vendet e ndryshme evropiane. Si rrjedhojë, personat e interesuar për shërbime të tilla do të kërkonin ndihmën e tij për të vepruar në atë mënyrë.

⁷ Shih përgjigjen e autoriteteve gjermane të datës 28 Shtator 2017;

⁸ Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor 6 nëntor 2017

⁹ Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor 6 nëntor 2017

- II. Rreth gjysmës së dytë të vitit 2011, në S., D. M., F. H. dhe B. B. e kontaktuan të pandehurin B. G. me po të njëjtin qëllim.
- III. Pas arritjes së marrëveshjes, B. G. do të merrte € 2.500 që ta dërgonte F. B. në I.
- IV. Në nëntor të vitit 2011, F. B. u transportua për në D., Sh., së bashku me të afërmin e tij B. B. dhe të pandehurin G., në veturën e të pandehurit H. A. që drejtohej nga po ai vetë.
- V. Kur arritën në D., i pandehuri G. i vuri B. dhe F. B. në kontakt me dy shtetas të Sh. me qëllimin e lehtësimit të udhëtimit të F. për në I. pa dokumentet e duhura.
- VI. Më pas u kuptua se F. ishte i mitur dhe pastaj u vendos që ata nuk do ta dërgonin atë në I. përmes portit të D..
- VII. Pastaj B. dhe F. B. u dërguan në T. nga B. G. dhe H. A.. Në T., ata patën një takim tjetër me dy shtetas të Sh., ku u diskutua mundësia e dërgimit të F. në I. përmes G. për shumën prej € 2.500 por që kjo nuk u realizua asnjëherë. Pastaj B. dhe F. B. u kthyen në K. nga të pandehurit.
- VIII. Po ashtu gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011, D. M. dhe F. H., që ishin të interesuar të shkonin jashtë vendit, kontaktuan me të pandehurin B. G..
- IX. Nga K. ata u transportuan për në T., Sh., në veturën e të pandehurit A., ku udhëtonte edhe i pandehuri G..
- X. Në T., i pandehuri G. organizoi që ata të takoheshin me një shtetas të Sh. i cili u siguroi atyre pasaporta biometrike të falsifikuara të R. së Sh..

- XI. Ata i dhanë 3500 € të pandehurit G. dhe D. M. ia dha edhe veturën e tij Volkswagen Golf.
- XII. Në të dyja herët, i pandehuri A. u shpërblye për shërbimet e tij të vozitjes.
- XIII. I pandehuri A. i transportoi M. dhe H. dhe i la ata afër kufirit me G., që ata pastaj e kaluan në këmbë.
- XIV. M. dhe H. pastaj e morën një traget nga G. për në I.. Me të arritur në Portin e B., I., ata u kapën nga policia i. me pasaporta të falsifikuara dhe u kthyen në G. ku edhe u arrestuan, kaluan pesë javë burg.
- XV. Përmes IRJM-së u kthyen në K.
- XVI. Të pandehurit B. G. dhe H. A., vepruan me qëllim me synimin e përbashkët që të lehtësonin transferimin e shtetasve të K. në vendet e tjera evropiane në këmbim të parave.
- XVII. Në të dyja rastet, të pandehurit B. G. dhe H. A. vepruan me mbështetjen e shtetasve të Sh..
- XVIII. Të dy, ishin në dijeni se ata persona nuk posedonin dokumente të vlefshme që do t'u mundësonin atyre t'i kalonin kufijtë e atyre vendeve në mënyrë të ligjshme.
- XIX. Të dy ishin plotësisht të aftë mendërisht.

E.2. Përmbledhje e fakteve të pavërtetuara

27. Nuk ka mundur të vërtetohej:

I. Se sa gjatë shtetasit e Sh. ishin duke punuar së bashku me të akuzuarit.

II. Se a ishte i njëjtë në të dyja rastet identiteti i këtyre shtetasve të Sh.

III. Se ka ekzistuar një lidhje ndërmjet të pandehurve dhe këtyre shtetasve të Sh. që kanë vepruar në të dyja rastet.

E.3. Analiza

28. Trupi gjykues e bazon vendimin në këtë rast në listën e provave më lart (D. Provat gjatë gjykimit).

Trupi gjykues po ashtu e konsideroi dëshminë e dëshmitarëve për vërtetimin e fakteve të pretenduara. Pas marrjes në pyetje të dy dëshmitarëve dhe deklaratat e të pandehurve, trupi gjykues paraqet këto shqyrtime:

29. Dëshmitari B. B. e ndërroi rrëfimin që ai fillimisht e paraqiti në shqyrtimin e parë gjyqësor.

30. Në shqyrtimin e parë gjyqësor, aspektet kryesore u rrëfyen nga ky dëshmitar si më poshtë:

31. Dëshmitari B. B.¹⁰ deklaroi se e njihte të pandehurin B. G. vetëm për nga pamja para se të kontaktonte me të për ta aranzhuar udhëtimin për në Sh.. Ai u vu në kontakt me të pasi që kushëriri i tij, F. B., dëshironte të shkonte jashtë vendit

¹⁰ Shih procesverbalin e seancës së 19 shtatorit 2013, prej faqe 10 deri në faqe 25, lidhja 11, Regjistratori i Gjykatës P 02/13, VËLLIMI III, Shqyrtimi gjyqësor;

dhe ai kishte dëgjuar se G. po u ndihmonte njerëzve për të shkuar jashtë vendit, qoftë legalisht ose ilegalisht.

32. Pastaj atij iu kujtua takimi i tyre i parë në kafe barin 'A. B.' në S., ku ata u pajtuan që F. do të dërgohej në I. për 2500 euro përmes Sh., D.. Nuk ishin paguar para në atë kohë, pasi që marrëveshja ishte që paratë të paguheshin sapo F. të mbërrinte në I.. Dëshmitari u arsyetua t'i kishte dhënë G. vetëm 100 euro, të cilat në fakt ishin paguar nga vëllai i F. për shpenzimet e realizuara gjatë udhëtimit.
33. Takimi ishte në dimrin e vitit 2011, afërsisht tre muaj para ditëlindjes së F., që është në ditën e Shën Valentinit (14 shkurt), siç u konfirmua nga dëshmitari. Prandaj, rreth nëntorit të vitit 2011.
34. Një ditë pas diskutimit për aranzhimin e udhëtimit, dëshmitari deklaroi se i kishte takuar të dy të pandehurit së bashku me kushëririn e tij F. në një motel në K. dhe se kishin filluar udhëtimin e tyre në një Opel Vectra të kuqe që drejtohej nga i pandehuri A.. Pastaj ata arritën në D. në Sh., ku qëndruan gjatë natës. Në mëngjes, dëshmitari pohoi se i kishte takuar të pandehurit sërish të shoqëruar nga dy persona të tjerë, shtetas të Sh., njëri prej të cilëve punonte për policinë, siç deklaroi dëshmitari që e kishte dëgjuar vetë nga ai person.
35. Kur shtetasit e Sh. e kuptuan se F. B. ishte i mitur, ata nuk pranuan që ta dërgonin atë jashtë vendit. Në atë pikë, dëshmitari përmendi në hollësi përfshirjen e të pandehuri G., i cili me këta dy persona diskutoi për një alternativë për dërgimin e F. jashtë vendit, ndërsa A., dëshmitari dhe F. ishin ulur diku tjetër.
36. Pastaj u nisën për në T.. Atje, dëshmitari, F. dhe i pandehuri G. diskutuan me dy shtetasit e Sh. për mundësinë e dërgimit të F. përmes G., por plani nuk u realizua

për faktin se dëshmitari dhe i njëjti F. nuk i kishin 2.500 euro që kërkoheshin për këtë.

37. Dëshmitari deklaroi se i pandehuri A. nuk ishte i pranishëm gjatë diskutimit lidhur me mundësinë që F. të udhëtonte përmes G.. Sidoqoftë, i gjithë udhëtimi kishte ndodhur me veturën e tij, të cilën e drejtonte A..
38. Dëshmitari pranoi se ai asnjëherë nuk e kishte pasur ndërmend të udhëtonte vetë për në I., por ai vetëm donte të shoqëronte kushëririn e tij deri në D..
39. Në shqyrtimin gjyqësor të tanishëm, dëshmitari B. B. duket se po përpiqet të bindë Gjykatën për një skenar tjetër, duke modifikuar deklaratën e tij në aspektet kryesore si vijon: arsyeja e tij për t'iu qasur G. si dhe shuma e parave të paguara/të nevojshme dhe kujt.
40. Ai tani pohon se ai dhe i pandehuri G. jetonin në lagjen e njëjtë. Dëshmitari pretendon se ai gjeti rastësisht se G. donte të shkonte jashtë vendit. Pasi që F. B., i afërmi i dëshmitarit donte të njëjtën gjë dhe ai ishte i mitur, dëshmitari mendoi se G. dhe B. mund të udhëtonin së bashku¹¹.
41. Kjo hipotezë nuk është bindëse. Dëshmitari ka dhënë disa deklarata në këtë çështje, por kjo është hera e parë kur ai e paraqet këtë rrëfim. Kjo teori në fakt nuk është vërtetuar me asnjë provë tjetër. Madje edhe vetë pandehurit nuk e kanë përmendur asnjëherë në deklaratat e tyre qëllimin e G. për t'u larguar nga vendi.
42. Për më tepër, kjo do të ishte në mospërputhje me veprimet konkrete të ndërmarra nga G. gjatë udhëtimeve për në Sh., kur ai e ndoqi nga afër pjesën

¹¹ Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të 14 qershorit 2017

tjetër të grupit – A., F. B. dhe B. B. në vend që të vazhdonte me qëllimin e tij për të shkuar jashtë vendit.

43. Për shembull, në udhëtimin e tyre të parë për në Sh., kur F. hasi probleme për shkak se ishte i mitur, G. udhëtoi së bashku me grupin për një periudhë kohore prej 3-4 ditësh në D., F. K. dhe T. dhe në fund u kthye në K. së bashku me ta. Dëshmitari nuk ofroi ndonjë arsye të veçantë ose shpjegim të besueshëm se pse G., nëse donte të shkonte jashtë vendit, nuk e ndiqte planin e tij dhe në vend të kësaj ai zgjodhi ta shoqëronte F..
44. Sjellja e përgjithshme e G. e mbështet fuqishëm faktin se arsyeja se pse ai e shoqëroi F. B. ishte në fakt për t'ia lehtësuar atij kalimin e kufirit.
45. Në deklaratën e tij të tanishme, B. B. pohon se në këmbim të vizës së F. dhe të shkuarjes jashtë vendit ai duhej të paguante 1.500 euro; paratë duhej t'i paguheshin "një personi nga Sh.", ka mundësi nga D.; ai nuk e njihte personalisht personin gjegjës, por kuptoi për të nga disa persona të tjerë në një kafene, që i ishin drejtuar dëshmitarit dhe ia kishin treguar atij "personin nga Sh.". Sipas dëshmitarit, "një person në një kafene na u drejtua dhe na informoi se ishte një djalë që mund t'i dërgonte njerëzit jashtë vendit"¹². Fillimisht, dëshmitari tha se ia kishte dhënë atij personi 1.500 euro. Më vonë gjatë deklaratës së tij, dëshmitari përmend shumë më të madhe prej 2.500 dhe ai specifikon se ai duhej t'ia dorëzonte paratë vetëm pasi F. ta kalonte kufirin¹³. Përveç rrëfimit të tij që ndryshonte dhe ishte kundërthënëse, ekziston një arsye kryesore se pse trupi gjykues konsideron se deklarata e tij e tanishme nuk është e besueshme, domethënë se është e palogjikshme dhe ka shumë pak të ngjarë që dëshmitari të hynte në çfarëdo transaksionesh monetare me individë krejtësisht të panjohur.

¹² Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të 14 qershorit 2017

¹³ Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të 30 gushtit 2017

46. Me anë të konkluzionit logjik, trupi gjykues konstaton se paratë ishin të destinuar për G., i cili në fakt ishte - siç u vërtetua më lart - personi që duhej të aranzhonte që F. të udhëtonte jashtë vendit.
47. Duhet të theksohet se dëshmitari po përpiqet ta justifikojë këtë devijim nga deklarata e tij e mëparshme për faktin se të dhënat e policisë nuk pasqyrojnë saktësisht atë që ai kishte treguar. Megjithatë, ai nuk jep ndonjë shpjegim të vlefshëm për ndryshimin e deklaratës që ai fillimisht e kishte dhënë para Gjykatës gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor.
48. Nga ana tjetër, në dëshminë e tij të tanishme, dëshmitari vazhdimisht e përsërit se ai i përmbahet deklaratave të tij të mëparshme, pasi që kujtesa e tij ishte më e freskët kur i kishte dhënë. Kjo i lë trupit gjykues mundësinë për të arritur në përfundim se deklarata e mëparshme e B. B. është ajo që i pasqyron saktësisht ngjarjet. Deklarata e mëparshme nuk përmban rrëfime kundërthënëse ose elemente që sfidojnë logjikën, siç janë ato që gjenden në deklaratat e dhëna gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe që janë theksuar më lart.
49. Kur është fjala për dëshmitarin F. H.¹⁴, ai mbronte në vija të përgjithshme aspektet e paraqitura para Gjykatës në shqyrtimin e parë gjyqësor.
50. Dëshmitari F. H.¹⁵ deklaroi se e njohte të pandehurin G. që nja 4-5 vjet.
51. Ai e kujtoi momentin kur u takuan me G. dhe A. dhe të gjithë u nisën për në Sh.. Më pas ai deklaroi se në T. u takuan me R. dhe një person tjetër, të dy shtetas të

¹⁴ Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të 1 marsit 2017

¹⁵ Shih procesverbalin e seancës së 19 shtatorit 2013, faqet 25 deri faqe 37, lidhja 11, Regjistratori i Gjykatës P 02/13, VËLLIMI III, Shqyrtimi gjyqësor;

Sh., dhe priti dy ose tre ditë për t'i marrë dokumentet e falsifikuara të Sh. që ishin rregulluar për ta.

52. Pas marrjes së dokumenteve, ata u transportuan nga dy shtetasit e Sh. për në S., ku qëndruan dy ditë para se ta kalonin kufirin. Në S., dëshmitari pohoi se ishte takuar përsëri me G. dhe A. dhe se kishin të gjithë së bashku; pak më vonë, ai vetë dhe D. M. e kishin kaluar ilegalisht kufirin për në G.. Ai më tej shtoi se në fakt kishte diskutuar me G. modalitetet se si të kalonin kufirin e përmendur.
53. Dëshmitari më tej shtoi se ai, D. M., R. dhe mikut i R. në të vërtetë ishin dërguar deri në kufi me veturën që drejtohej nga i pandehuri A., pas së cilës R. dhe A. u kthyen prapa me veturë, ndërsa të tjerët e kaluan kufirin në mënyrë të paligjshme në këmbë.
54. Dëshmitari deklaroi se i ka dhënë të pandehuri B. G. 3500 euro kur shkuan në T., brenda veturës, dhe se D. M. ia ka dhënë veturën e tij, një Golf 3. Sipas vlerësimit të dëshmitarit, vlera e veturës ishte 3.500 euro¹⁶.

Trupi gjykues e ka gjetur deklaratën e F. H. si të besueshme dhe që meriton besim dhe se mbështetet plotësisht në të, kur i vërteton faktet relevante për rastin.

55. Kur është fjala për H. A., të dy dëshmitarët deklaruan se nuk ata nuk e njihnin atë, por ata mund ta njihnin atë pikërisht për shkak të udhëtimeve të vitit 2011. Në të vërtetë, F. H. deklaroi se kurrë nuk kishte diskutuar asgjë me A., e edhe B. deklaroi se A. nuk ishte përfshirë në diskutimin lidhur me një rrugën alternative për transportimin e F. për në I..

¹⁶ Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të 1 marsit 2017

56. Trupi gjykues i baraspeshonte deklaratat e tilla koherente dhe vërtetuese me deklaratat e të pandehurve - të dhëna në shqyrtimin e parë gjyqësor dhe që u mbrojtën nga të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor të tanishëm, me A. që e nënvizonte rolin e tij ekskluziv si shofer¹⁷ - dhe gjeti disa mospërputhje në deklaratat e këtij të fundit.
57. I pandehuri B. G.¹⁸ deklaroi se ka shkuar disa herë në Sh. mes viteve 2008 dhe 2010 për arsye mjekësore që lidheshin me gruan e tij dhe në vitin 2011 që lidheshin me xhaxhain e tij.
58. I pandehuri e pranoi faktin se F. H. kishte shkuar me të, A. dhe D. M. në Sh., por arsyeja ishte sepse kishte nevojë për transport deri atje dhe ai shfrytëzoi mundësinë që ta merrte këtë me te i pandehuri. Sapo arritën në Sh., i pandehuri tha se ishte kthyer të nesërmen. Ai deklaroi se A. e kishte paguar vetëm për shpenzimet e karburantit, domethënë rreth 50 ose 70 euro. Ai po ashtu konfirmoi se e njohte personin e quajtur R. dhe se ai e kishte ndihmuar atë gjatë kohës kur xhaxhai i tij ishte në Spitalin Ushtarak të T., pasi që daja i R. punonte në këtë spital si zëvendësdrejtor. I pandehuri gjithashtu argumentoi se në fakt dëshmitari i ka borxh atij para pas blerjes së një pjese të rrobave për dasmën e dëshmitarit në vlerë prej 2700 euro.
59. I pandehuri gjithashtu pranoi se kishte udhëtuar për në D. me B. B. dhe kushëririn e tij, F. B., me A. që e drejtonte veturën me ta në veturën e tij. Ai deklaroi se kishte qëndruar në D. për dy net dhe se kishte paguar tarifat e hotelit të A. (megjithëse ai fillimisht tha se nuk atij nuk i kujtohej nëse A. e kishte kaluar natën në D.) dhe se ia kishte dhënë përsëri rreth 50 euro për shpenzimet e karburantit. I pandehuri më tej pohoi se Golf 3 që ai e shfrytëzonte nuk i përkiste D. M., por një personi me emrin E. R.. I pandehuri shtoi se ai e

¹⁷ Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të 6 nëntorit 2017

¹⁸ Shih procesverbalin e seancës së 23 shtatorit 2013, faqe 26 deri 44, lidhja 9, Regjistratori i Gjykatës P 2/13, VËLLIMI III, Shqyrtimi gjyqësor;

përdori A. për ta vozitur atë për punët e tij dhe se ai do ta paguante kur ai të kishte para për këtë.

60. I pandehuri H. A.¹⁹ deklaroi se e njohte G. që nga koha kur ata ishin fëmijë dhe se i kishte dërguar me veturë atë dhe gruan e tij në Sh. nganjëherë në vitin 2011 në mënyrë që G. ta vizitonte xhaxhain e tij i cili ishte i shtruar në spital atje.
61. Pastaj ai e pranoi ta ketë transportuar F. H. për në Sh. në veturën e tij gjatë të njëjtit udhëtim ku ai e kishte sjellë G. në spital. Në deklaratën e tij, ai në të vërtetë e konfirmoi atë çfarë ishte përmendur nga F. H., domethënë se ata ishin takuar në K. dhe se ata shkuan me dy vetura të ndryshme deri në ETC në P., ku ata më pas vazhduan për në Sh. të gjithë në veturën e A., ndërsa vetura e D. M. ishte lënë në parkingun e ETC-së. Megjithatë, i pandehuri argumentoi se ai nuk ka qenë në dijeni të arsyeve se pse F. H. dhe D. M. udhëtuan në veturën e tij dhe se e vetmja temë e diskutimit gjatë udhëtimit kishte të bënte me vajzat.
62. Vetëm pas u mor në pyetje nga prokurori, të pandehurit iu kujtua ta kishte vozitur edhe B. B. për në D., në Sh..
63. Ai deklaroi se ishte kthyer prapë në K. në të njëjtën ditë në të dyja rastet dhe se edhe pandehuri G. ishte kthyer me të.
64. Më pas i pandehuri shtoi se kam qenë duke vozitur të pandehurin G. atypari, sepse ky i fundit ishte përfshirë në një aksident dhe gjendja e tij psikologjike nuk ishte e mirë. Në shkëmbim të kësaj, G. do të kompensonte shpenzimet e tij të karburantit. Ai, pra, e konfirmoi atë që u tha nga G., domethënë se me rastin e dy udhëtimeve ai ishte paguar rreth 50 euro si kompensim për shpenzimet e karburantit.

¹⁹ Po aty, faqet 7 deri 25;

65. Trupi gjykues ka gjetur disa kundërthënie në deklaratat e të pandehurve, për dallim nga dëshmitarët.
66. Të pandehurit kanë deklaruar se janë shokë shumë të mirë, por i pandehuri A. ka deklaruar se kurrë nuk e kishte diskutuar me të pandehurin se me çfarë llojit të biznesit po merrej.
67. Ka qenë shumë joreal fakti se në dy raste, të panjohurit janë futur në veturën e të pandehurit A. dhe janë dërguar në Sh., por arsyeja e udhëtimit të tyre asnjëherë nuk është diskutuar apo nuk është bërë pyetje nga A.. Për më tepër, me sa duket të pandehurit asnjëherë nuk kanë diskutuar arsyen se pse G. po e voziste veturën e D. M.. Duket rikujtuar se të dy udhëtimet kanë zgjatur për disa ditë dhe nuk ishin vetëm udhëtime njëditore, sipas dëshmitarëve.
68. I pandehuri A. fillimisht ka deklaruar se kishte shkuar vetëm në T., për të shtuar pastaj më vonë se gjithashtu kishte shkuar edhe në D.. Në lidhje me këtë udhëtim në D., A. së pari ka thënë se B. ka qenë me dikë tjetër, kurse më vonë ai ka thënë se në fakt B. ka qenë vetëm.
69. Kundërthënie gjithashtu u paraqitën edhe në lidhje me kohën e kaluar nga të pandehurit në Sh.. A. ka deklaruar se është kthyer në K. në të njëjtën ditë të udhëtimit në të dy rastet dhe se G. është kthyer me të. Lidhur me udhëtimin në T., G. fillimisht ka thënë se e kanë kaluar natën në T., por pastaj e tërhoqi atë dhe deklaroi se është kthyer në të njëjtën ditë. Në lidhje me udhëtimin në D., G. ka pohuar se ka qëndruar aty dy natë. Ai fillimisht ka thënë se nuk i kujtohet sa kohë ka qëndruar A., por më vonë ai e kundërshtoi vetën kur deklaroi se kishte paguar shpenzimet e hotelit për A..
70. Trupi gjykues gjithashtu ka gjetur kundërthënie në arsyet e paraqitura nga i pandehuri G. për udhëtimin në T. në periudhën kritike. I pandehuri ka deklaruar se e kishte vizituar axhën e tij i cili ishte hospitalizuar në spitalin e T.. Sidoqoftë,

në raportin mjekësor të axhës së tij H. G., të dorëzuar gjatë seancës më 24 shtator 2013²⁰, datat e hospitalizimit rezultojnë të jenë prej 29 gushtit 2011 deri më 19 shtator 2011. Dëshmitari B. B. rikujton se udhëtimi ka ndodhur rreth nëntorit 2011. I njëjti i pandehur G. ka deklaruar se në udhëtimin për në T. ka qenë me dëshmitarin F. H. në nëntor 2011²¹. Prandaj, datat e hospitalizimit të axhës së G. nuk përputhen me periudhën kritike në të cilën kanë ndodhur udhëtimet me dëshmitarin, përkatësisht nëntor 2011.

71. Në lidhje me paratë e pranuar nga i pandehuri A., i njëjti e ka pranuar se ka vepruar si vozitës i taksisë për shokun e tij G.. Sidoqoftë, kur ai gjithashtu ka vozitur persona të tjerë të panjohur në këtë rast, ai ka deklaruar se në atë rast gjithashtu është paguar vetëm për shpenzimet e derivateve.
72. Mbrojtja e paraqitur nga A., përkatësisht se ka qenë krejtësisht i pavëmendshëm ndaj natyrës së veprimeve pjesë e të cilave ishte ai, nuk mund të pranohet. Kjo hipotezë kundërshtohet nga fakti se A. po i shoqëronte grupet për periudhat të cilat kanë zgjatur disa ditë dhe ka qëndruar në hotele të ndryshme së bashku me ta. Ai i ka vozitur personat deri në kufi dhe i ka lënë aty.
73. Për më tepër, G. nuk ka mundur të japë një shpjegim të besueshëm për arsyen se pse në shtëpinë e tij janë gjetur dy letërnjoftime g. gjatë bastisjes më 22 tetor 2013. Gjykata nuk e gjeti të besueshme atë që është deklaruar nga i pandehuri, përkatësisht se i kishte gjetur letërnjoftimet në rrugë në T. dhe thjeshtë i ka mbajtur ato në vend se t'i dorëzojë ato tek autoritetet. Kjo tregon se i pandehuri G. ka pasur mundësi të merret dokumente të huaja - të zonës schengen. Kjo konsiderohet si provë rrethanore.
74. Për ta përfunduar, faktet e vërtetuara kanë të bëjnë me dy ngjarje të ndara, me të njëjtën metodë të veprimit, me B. B. që ka pasur udhëheqjen dhe ka krijuar

²⁰ Prova materiale 12;

²¹ Shih procesverbalin e shqyrtimit të 23 shtatorit 2013, faqet 38, lidhja 9, Regjistratori i gjykatës P 2/13, VOLUMI III, Shqyrtimi gjyqësor;

kontaktet me shtetasit e Sh. për të mundësuar transportimin e personave jashtë vendit dhe me H. A. i cila ka pasur rol më të vogël, kryesisht sigurimin e transportimit të grupeve me veturën e tij Opel Vectra të kuqe.

75. Prandaj, duke e marrë parasysh atë që u tha më lart, duke u bazuara në pjesë të deklaratave të dëshmitarëve të konsideruara si kredibile dhe të besueshme, dhe në prova tjera rrethore, është vërtetuar gjendja faktike e shtjelluar më lart nën Kapitullin E.1.
76. Prandaj, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri G. ka gjetur emigrantët e interesuar për të udhëtuar jashtë vendit dhe ka gjetur mënyrën për t'i sjellë ata në Sh. ku i vinte në kontakt me personat e tjerë të cilët pastaj mundësonin ose përpiqeshin të mundësonin udhëtimin e tyre. Ai e ka bërë këtë në këmbim të parave ose dobisë pasurore, gjegjësisht veturës Golf 3.
77. Gjithashtu është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri A. ka vepruar si vozitës i grupit, kështu duke siguruar mjetin për udhëtim nga K. në Sh., duke i dërguar ata tek vendi ku pastaj kontaktonin me shtetasit e Sh.. Ai e dinte se cili ishte qëllimi i udhëtimit dhe për këtë ka pranuar para.
78. Fakti që A. ka qenë i autorizuar si shofer taksie nuk ka peshë në këtë përgjegjësi penale ndaj akuzave të ngritura. Ai nuk është duke u gjykuar për vozitjen e njerëzve pa pasur leje taksie. Fakti që ai është shoferi i autorizuar taksie nuk e përjashton atë nga përgjegjësia penale për sjelljen e ngritur në Aktakuzë.

79. Nuk ka mundur të vërtetohet nëse të dy shtetasit e Sh. të takuar nga B. dhe F. B. kanë qenë të njëjtit me të cilët janë takuar F. H. dhe D. M.. Në fakt, asnjë provë e detajuar nuk është paraqitur përkitazi me këtë.
80. Gjykata, më tutje konstaton se vepra penale nuk ka qenë shumë e ndërlikuar për nga natyra, edhe pse përfshinë disa elemente transnacionale. Asnjë organizatë e ndërlikuar nuk ka dalë nga provat. Në vend të kësaj, është zbuluar një kontrabandim ad hoc, ku imigrantët kanë kërkuar ndihmën e kontrabanduesve për pjesë të udhëtimit të tyre. Kjo e ka konsoliduar bindjen e gjykatës se të pandehurit nuk kanë qenë pjesë e një rrjeti të fortë kriminelësh, por që mbështeteshin në disa persona të njohshëm me të cilët bashkëpunonin në baza eventuale.

F. GJETJET LIGJORE

I. Ligji i zbatueshëm

81. Ngjarjet e vërtetuara më lart kanë ndodhur diku në gjysmën e dytë të vitit 2011, kur ligji i zbatueshëm ka qenë Kodi Penal i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 06 prill 2004 nën emrin Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Ky kod është ndryshuar më 06 nëntor 2008, thjeshtë vetëm duke e ndryshuar emrin në Kodi Penal i Kosovës. Sidoqoftë, Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës (KPRK, Kodi Nr. 04/L-082) ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013.

82. Trupi gjykues thekson se edhe ligji i vjetër (KPK) edhe ligji i ri (KPRK) shprehin parimin e përbashkët në ligjin penal: “Ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të zbatohet ndaj të kryerësit”²². Sidoqoftë, të dy ligjet

²² Neni 2(1) i KPK-së dhe neni 3(1) i KPRK-së.

shprehin përjashtimin e pranuar universal: “Në rast se ligjin në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm”²³.

83. Trupi gjykues e interpretoi këtë kryesisht duke i shikuar elementet thelbësore të veprës penale, por gjithashtu edhe shkallën dhe llogaritjen e ndonjë dënimi të bashkuar.

II. Përgjegjësia penale

84. Neni 11(1) i KPK-së ose neni 17(1) i KPRK-së përcakton qartë se kryerësi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me “dashje apo nga pakujdesia”.

III. Veprat penale

i) Kontrabandimi me migrantë

85. Neni 138 i KPK-së përcakton:

(1) Kushdo që merret me trafikim të migrantëve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

(...)

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet nga kryerësi si anëtar i grupit ose në një mënyrë e cila rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë jetët a sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshinë trajtimin çnjerëzor a degradues,

²³ Neni 2(2) i KPK-së (përdorë fjalën ‘më’) dhe neni 3(2) i KPRK-së (përdorën fjalën ‘më’).

duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë, ai dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

(7) Sipas këtij neni,

1) Shprehja "kontrabandim me migrantë " do të thotë prokurim me qëllim të fitimit të drejtpërdrejtë ose tërthorazi të një dobie pasurore a financiare i një hyrjeje të paligjshme të personit (...), ose në shtetin në të cilin personi nuk është banor i përhershëm ose shtetas.

2) Shprehja "hyrje e paligjshme " do të thotë (...) kalimi i kufijve të shtetit pa i respektuar kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet. (...).

86. Neni 138 i KPK-së bazohet në Protokollin kundër kontrabandimit me migrantë përmes tokës, detit dhe ajrit, plotësim i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (KKBKOT), të miratuar e nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 55/25 të 15 nëntorit 2000²⁴.

87. Vepra penale kontrabandim me migrantë ekziston kur kontrabanduesi ka prokuruar ose ia ka mundësuar migrantit që të hyjë dhe të qëndrojë në një shtet në të cilin migranti nuk është shtetas ose banor i përhershëm, dhe nuk i ka poseduar dokumentet e nevojshme të kërkuara me ligjin a atij shteti. Kontrabanduesi do ta ketë prokuruar hyrjen ose siguruar këtë ndihmë për përfitim e një dobie pasurore a financiare.

88. Veprimi kriminal përmban tri elemente të cilat duhet të vërtetohen: prokurimi, hyrja e paligjshme dhe përfitimi financiar ose dobia tjetër pasurore.

89. Prokurimi i referohet aktit të shkaktimi ose mundësimit të një ngjarjeje. Prokurimi mund të definohet si një akt për të "marrë diçka ose për të shkaktuar

²⁴ Shih gjithashtu UNODC Ligji Model kundër Kontrabandimit me Migrantë, 2010; Ky Ligj Model është zhvilluar për t'i ndihmuar shtetet në zbatimin e dispozitave të përmbajtura në Protokollin kundër kontrabandimit me migrantë përmes tokës, detit dhe ajrit, plotësim i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (KKBKOT);

nj rezultat me përpjekje”²⁵. Në rastin e kontrabandimit me migrantë, prokurimi do të mund të përfshinte veprimet e kontrabanduesit në organizimin, rekrutimin dhe aranzhimin e hyrjes së paligjshme të migrantit. Në këtë mënyrë, kontrabanduesi ka “shkaktuar rezultatin” i cili ishte hyrja e paligjshme e migrantit, “me përpjekje” që ka qenë organizimi dhe aranzhimi.

90. Prokurimi i hyrjes së paligjshme së një personi në një shtet të huaj përfshin aranzhimin e të gjitha aspekteve të operacionit të kontrabandimit, si rekrutimin e personave të gatshëm për të dalë jashtë shtetit, negociatat për të ndërmarrë një përpjekje të tillë, ndërlidhja me akterët e tjerë të mundshëm, aranzhimi dhe sigurimi i logjistikës adekuate (dokumentacioni, strehimi, etj.) dhe transporti përtej kufirit.

91. Shprehja "hyrje e paligjshme" do të thotë, siç është cituar, kalimi i kufijve të shtetit pa i respektuar kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet, sipas nenit 138, § 7, 2) të KPK-së.

92. Elementi i përfitimit financiar ose material gjithashtu duhet të jetë i pranishëm. Kjo ndan ata që janë të motivuar nga përfitimi nga personat të cilët mund të kenë ndihmuar migrantët pa asnjë shpërblim ose për qëllime altruiste.

93. Duke pasur parasysh se elementet e ndryshme të cilat e përbëjnë veprën penale kontrabandim me migrantë dhe faktin që përfshinë një element të transnacionalitetit, është pranuar se kryerja ose kryerja në tentativë e një vepre të tillë angazhon një varg individësh të cilët përmes roleve të ndryshme, hapave të ndryshëm dhe përmes shteteve të ndryshme mundësojnë përfundimin e veprës penale ose tentativën për përfundimin e saj.

²⁵ Shih faqe 5 e ZDKKB Doracaku i detajuar i trajnimit për hetimin dhe ndjekjen penale të kontrabandimit me migrantë, Moduli 1;

94. Pasi të përcaktohet se migranti ka kaluar kufirin siç është përcaktuar me legjislacionin përkatës, duhet të bëhet një vlerësim për të përcaktuar se kush ka qenë i përfshirë për ta ndihmuar, mundësuar apo prokuruar kalimin e kufirit. Për shembull, një kontrabandues mund t'ia sigurojë migrantit dokumentet e falsifikuara dhe tjetri mund t'ia sigurojë transportin atij apo asaj. Vepra penale kontrabandim me migrantë kap sjelljen e të dy kontrabanduesve sepse të dytë kanë ndihmuar ose prokuruar hyrjen e paligjshme të migrantit edhe pse vetëm njëri kontrabandues fizikisht e ka vozitur migrantin matanë kufirit.

95. Provat e shtjelluara më lart kanë vërtetuar se të paktën për rreth gjashtë muaj, domethënë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011, të pandehurit B. G. dhe H. A. kanë vepruar në bashkëpunim me qëllim të përfitimit financiar duke organizuar gjetjen e disa personave të interesuar për të dalë jashtë vendit dhe transportin e tyre në Sh. në mënyrë që ata pastaj të kalojnë në një shtet tjetër evropian me ndihmën e individëve të tjerë në Sh..

96. Këta persona kanë pasur role të ndryshme, me G. i cili ka vepruar si lidhje koordinuese dhe e negociemeve, A. duke siguruar mjetet për transportimin e migrantëve në Sh. dhe disa shtetas të Sh. të cilët kanë siguruar pasaporta të falsifikuara dhe mjetet dhe ndihmën për kalimin e kufirit të Sh..

97. I pandehuri G. ka qenë pikë referimi për personat që dëshironin të dilnin jashtë shtetit. Të paktën tre migrantë kanë parë udhëtimin e tyre të organizuar nga ai pas negociatave që ishin bërë dhe çmimit të caktuar. Pastaj migrantët janë transportuar nga i pandehuri A. me veturën e tij deri në vendin transit. I pandehuri G. ka udhëtuar me ta dhe në Sh. është lidhur me personat e tjerë të cilët kanë mundësuar ose kanë mundësuar në tentativë kalimin e tyre në G. ose I. I pandehuri G. ka koordinuar operacionin dhe ka kontaktuar me shtetasit e Sh. për të mundësuar transportimin e personave jashtë shtetit. H. A. ka pasur rol më të vogël, përkatësisht sigurimin e transportimit të grupeve duke i vozitur me veturën e tij Opel Vectra të kuqe.

98. Në një rast dy migrantët – D. M. dhe F. H. – kanë qenë të suksesshëm në kalimin e kufirit G. dhe I, pas të cilit janë arrestuar nga Policia.

99. Në një rast tjetër, migranti tjetër F. B., nuk ka arritur të largohet nga Sh. përkundër diskutimit të disa planeve.

100. Të gjitha elementet e veprës penale janë të pranishme në veprimin e parë të të pandehurve: prokurimi, dobia pasurore dhe hyrja e paligjshme në një shtet në të cilin migrantët nuk janë shtetas. Në lidhje me veprimin e dytë mungon përfundimi i veprës penale: F. B. asnjëherë nuk ka hyrë paligjshëm në ndonjë shtet.

101. Pastaj të pandehurit kanë shkelur më shumë se një herë statutin i cili parasheh dënimin e kontrabandimit me migrantë me më shumë se një veprim. Megjithatë, ata e kanë bërë këtë me të njëjtin qëllim kriminal, i cili rrjedhimisht i unifikon veprimet e tyre. Në fakt, qëllimi fillestar i mundësimit të transferimit të shtetasve të K. në shtetet tjera ka vazhduar gjatë gjithë periudhës kohore gjatë së cilës ata i janë përkushtuar një aktiviteti të tillë.

102. Rrjedhimisht, megjithëse janë dy, të dy veprimet përbëjnë vetëm një vepër penale.

103. Prandaj, trupi gjykues ka gjetur se veprimet e të pandehurve përbëjnë kryerje të veprës penale ‘Kontrabandim me migrantë’ të dënueshme sipas nenit 138(1) të KPK-së me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

104. Përveç kësaj, të pandehurit janë akuzuar sipas nenit 138(6) të KPK-së edhe për “veprim si anëtar i grupit”.

105. Gjykata konsideron se nocioni i “grupit” i paraparë në nenin 138(6) të KPK-së është i ndryshëm dhe më i gjerë se sa definicioni i “grupit të organizuar kriminal” i paraqitur në nenin 274 të KPK-së. Sipas Kodit, të qenit pjesë e grupit të kontrabanduesve bartë një dënim unik, kurse të qenit pjesë e një grupi të organizuar kriminal është vepër penale në vetvete, nëse kryhet një krim i rëndë – domethënë një vepër penale e dënueshme me burgim prej të paktën vjet. Dënimi i paraparë me nenin 138 (6) e përmbush këtë kriterin e fundit, siç është përmendur *infra*²⁶. Gjykata supozon se nuk ka qenë qëllimi i ligjvënësit që ta dënojë saktësisht të njëjtin akt kriminal në dy vepra penale me dy dënime të ndryshme; me fjalë të tjera, t’i përsërisin elementet e njëjta të veprës në dy dispozita të ndryshme për të përfunduar me dy dënime të ndryshme. Duke qenë një grup i organizuar kriminal tashmë i dënueshëm sipas nenit 274 nuk duket se ka një qëllim ose logjikë për ta përfshirë atë në ndonjë dispozitë tjetër.

106. Ligji Model i ZDKKB propozon si një faktor rëndues opsional nëse “vepra penale është kryer si pjesë e aktivitetit të një grupi të organizuar kriminal”.²⁷ Formulimi i ligjit model është i ndryshëm nga formulimi i nenit 138 (6) të KPK-së. Trupi gjykues konsideron se duke e përdorur shprehjen “anëtar i grupit” do të thotë diçka më pak se “pjesë e aktivitetit të grupit të organizuar kriminal”. Ky gjithashtu është një kuptim i natyrshëm i formulimit.

107. Nocioni i grupit i paraqitur në nenin 138(6) duhet të nënkuptojë diçka tjetër që tashmë nuk mbulohet në mënyrë strikte nga statuti i përgjithshëm i cili ndalon grupet e organizuara kriminale. Neni 138 i KPK-së mbulon të gjitha format e kontrabandimit me migrantë. Prandaj, grupi kontrabandues nuk i referohet grupit të organizuar në mënyrën e paraparë me nenin 274 dhe mund të jetë një ‘rrjet i lidhur dobët’. Më saktësisht, grupi nuk ka nevojë të ekzistojë për një periudhë të zgjatur kohore.

²⁶ Shih paragrafin 134;

²⁷ ZDKKB: Ligji Model kundër kontrabandimit me migrantë, faqe 46;

108. Nëse një grup i organizuar kriminal do të kontrabandonte migrantë, vepra penale 'Krim i organizuar' do ta konsumonte veprën penale Kontrabandim me migrantë. Siç është theksuar nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj Ap-Kz nr. 61/12, "Formulimi i përdorur në tërë nenin 274 të KPK-së në mënyrë të qartë përcakton që kryerja e veprës themelore është element përbërës i kësaj vepre. Përndryshe, një individ mund të shpallet fajtor për të njëjtën veprë, duke u bërë pjesë e të dyja veprave penale, pra të krimit të organizuar dhe të veprës bazë. Kjo gjendje mund të përbëjë shkelje të ndalimit për shqiptimin e dënimit të dyfishtë për të një veprë penale. Në lëndën në fjalë, vepra e krimit të organizuar në një masë të caktuar përfshin edhe veprën penale të kontrabandimit me migrantë".

109. Provat tregojnë se të pandehurit janë ndihmuar nga disa shtetas të Shqipërisë në detyrat e tyre për të dërguar migrantë në mënyrë të paligjshme në shtetet e jashtme. Ky aktivitet duket të jetë një kontrabandim *ad hoc* ku nevoja për ndihmë nga kontrabanduesit nuk është shumë e lartë: migrantët kishin nevojë për ndihmën e kontrabanduesve vetëm për pjesë të udhëtimit të tyre, për të marrë dokumentet e udhëtimit dhe për t'u transportuar matanë kufirit pa u zbuluar.

110. Gjykata përfundon se kontrabandimi me migrantë i përmendur në mënyrë të qartë e angazhon nenin 138(6) të KPK-së si një faktor rëndues²⁸. Të dy të akuzuarit kanë vepruar si anëtarë të grupit të përbërë në secilin rast nga katër persona, një shoqëri e cila mundësoi biznesin e paligjshëm përmes ndarjes së detyrave.

²⁸ Gjykata nuk do t'i diskutoj arsye këtu se pse e konsideron nenin 138(6) të KPK-së rrethanë rënduese për veprën penale bazë të përcaktuar sipas nenit 138(1), duke e pasur parasysh se vepra penale bazë është e dënueshme me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet dhe një fajësim i shtuar dhe më i fuqishëm është i dënueshëm me burgim prej dy deri në dhjetë vjet, disi i fton kriminelët që të organizohen në grupe për të kryer më mirë aktivitetet e tyre ose për t'i trajtuar migrantët në mënyrë çnjerëzore.

111. Pas vërtetimit të veprës penale të kryer (*actus reus*), trupi gjykues u kthye për të vlerësuar nëse elementet subjektive (të ashtuquajturat *mens rea*) të të pandehurve mund të vërtetohen.

112. Sipas nenit 11 paragrafit (1) të KPK-së, personi konsiderohet penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Sipas dispozitës së njëjtë, personi është fajtor për kryerjen e një vepre penale në rast se ai e kryen veprën penale me dashje apo nga pakujdesia.

113. Prandaj, janë dy elemente që duhet të merren parasysh: aftësia mendore e personit dhe dashja për të kryer ose pakujdesia në kryerjen e një veprë penale.

114. Së pari, nuk ka asnjë dyshim sa i përket faktit se të pandehurit B. G. dhe H. A. kanë qenë të gjithë plotësisht mendërisht të aftë gjatë kohës kritike. Në fakt, kjo çështje asnjëherë nuk ka qenë temë e argumentimit gjatë procedurës.

115. Së dyti, trupi gjykues është dashur të vlerësojë nëse, gjatë kryerjes së veprës penale të vërtetuar më lart, të pandehurit kanë vepruar me dashje. Ligji e kërkon dashjen si formë e *mens rea* para se të mund të vërtetohet përgjegjësia penale, pasi që pakujdesia është përjashtim (neni 11 (3) i KPK-së).

116. Neni 15 i KPK-së, në përshkrimin e nocionit të dashjes, përcakton se: "(1) Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale. (2) Personi vepron me dashje kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj. (3) Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj".

117. Trupi gjykues konstaton se përkufizimi i dashjes direkte është i qartë: personi është i vetëdijshëm për veprën e tij dhe dëshiron ta bëjë atë. Me fjalë të

tjera, autori duhet t'i njohë elementet e veprës penale (elementi kognitiv) dhe të ketë vullnetin për ta sjellë përfundimin e saj (elementi i vullnetshëm).

118. Siç është theksuar më lart, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kanë vepruar në bashkëpunim kur janë përfshirë në veprimtarinë e kontrabandimit. Prandaj, ata janë takuar dhe kanë vepruar me vetëdije të plotë për veprimet e tyre dhe me dashje direkte për të mundësuar lëvizjen jashtë vendit të palëve të dëmtuara/dëshmitarëve.

ii) Krimi i organizuar

119. Neni 274, § 1 i KPK-së përcakton se:

“§ 1. Kushdo që kryer krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet.”

120. Neni 274, § 7 i KPK-së, përcakton disa definicione kyçe:

“§ 7. Sipas këtij neni,

1) Shprehja “krim i organizuar” do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare.

2) Shprehja “grup kriminal i organizuar” do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare.

3) Shprehja “krim i rëndë ” do të thotë vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet.

4) Shprehja "grup i strukturuar " do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar."

121. Aktivitetet e të pandehurve të ndërmarra së bashku duhet të plotësojnë prapen e përkufizimit të krimit të organizuar: se grupi ka qenë i strukturuar, ka ekzistuar për një kohë të caktuar dhe është themeluar për kryerjen e një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të dobisë pasurore apo financiare për të pandehurit.

122. Neni 274, § 7 pika (3) e KPK-së e përkufizon "krimin e rëndë " si një vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet. Siç është theksuar më lart, vepra penale kontrabandim me migrantë dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet. Prandaj, burgimi prej së paku katër vjet është i mundshëm dhe vepra penale cilësohet si krim i rëndë.

123. Trupi gjykues i referohet jurisprudencës së Gjykatës Supreme të Kosovës e cila më tutje e sqaron dhe e mbështet interpretimin e përmendur më lart. Në aktgjykimin e saj Ap-Kz.Nr. 349/2007 të datës 2 korrik 2009, Gjykata Supreme është dashur të vlerësojë se çfarë mund të përbëjë një krim të rëndë për qëllime të vërtetimit të Krimit të organizuar. Vepra penale në fjalë përfshinte trafikim të drogës dhe Gjykata Supreme ka theksuar se vepra të tilla penale mund të konsiderohen krim i rëndë sepse burgimi prej 4 viteve ka qenë në gamën e burgimit të paraparë nga ato vepra penale.

124. Siç është përmendur tashmë, është konsideruar e vërtetuar se ky grup i personave ka mundësuar transferimin e shtetasve të Kosovën në vende të tjera Evropiane përfshinte persona të tjerë përveç G. dhe A., të cilën i kanë ndihmuar ata me aktivitetet e tyre të kundërligjshme. Sidoqoftë, nuk ka mundur të vërtetohet se identiteti i këtyre shtetasve të Sh. ka qenë i njëjti në të dy rastet

dhe se ka pasur një lidhje në midis këtyre shtetasve të Shqipërisë të cilët kanë vepruar në të dyja rastet. As nuk ka mundur të vërtetohet se për sa kohë kanë punuar këta shtetas të Sh. me të akuzuarit.

125. Prandaj, gjykata mund vetëm t përfundojë se në të dy rastet kanë vepruar dy grupe të ndryshme, të dy grupet përmbajnë katër elemente, përkatësisht dy të akuzuarit dhe dy shtetas të tjerë të Sh., duke ndihmuar kontrabandimin e F. B. si dhe D. M. dhe F. H.. Siç u cek, asnjë lidhje midis dy grupeve të shtetasve të Sh. nuk është vërtetuar. Më me rëndësi, nuk është vërtetuar se këta shtetas të Sh. kanë punuar me të pandehurit në më shumë se një rast ose që bashkëpunimi i tyre ka qenë diçka më shumë se vetëm punë e kryer një herë.

126. Prandaj, trupi gjykues nuk ka mundur të gjejë të vërtetuara elementet cilësuese të veprës penale 'Krim i organizuar. Përkatësisht, elementi i stabilitetit të grupit i paraparë në pikën (2) § 7 nuk është gjetur.

127. Pasi që elementet që e kualifikojnë këtë vepër penale në ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së akteve kriminale nuk janë gjetur, është e tepërt të analizohet se cilat kanë qenë elementet përbërëse të një vepre penale të tillë janë në KPRK e ri, pasi që siç u theksuar më lart në paragrafin 75 "Ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të zbatohet ndaj të kryerësit".

ii) Ri-cilësimi

128. Pasi që elementet e krimit të organizuar nuk kanë mundur të vërtetohen, trupi gjykues e ri-cilëson veprën penale fillestare nga krim i organizuar në lidhje me kontrabandimin me migrantë në veprën penale kontrabandim me migrantë.

129. Kështu, trupi gjykues i gjen të pandehurit B. G. dhe H. A. fajtorë dhe penalisht përgjegjës për veprën penale 'Kontrabandim me migrantë.

130. Kodi i ri penal gjithashtu e dënon kontrabandimin me migrantë sipas nenit 170 të tij. Ndryshimi i vetëm i rëndësishëm i paraqitur, përveç shkallës së re të dënimeve, është përkufizimi i veprës penale, i cili sipas nenit 170(8), pikës 8.1, përcakton: “Kontrabandimi me migrantë – çdo veprim me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti”.

131. Në thelb, elementet relevante të veprës penale mbeten të njëjta nën KPRK-në, ashtu si në KPK-ë. Ndryshimi i vetëm është zëvendësimi i aktit më strikt-prokurimit- me një shprehje më gjithëpërfshirëse dhe më pak specifike “çdo veprim”.

G. DËNIMI

132. Gjatë caktimit të sanksionit penal, gjykata duhet të marrë parasysh si qëllimin e përgjithshëm të dënimit, përkatësisht të shtypë aktivitetet e rrezikshme për shoqërinë duke i përmbajtur të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme kriminale, ashtu edhe qëllimin specifik që është të parandalojë kryerësin nga përsëritja e veprës penale. Sipas nenit 34 të KPK-së: “Qëllimet e dënimit janë: 1) të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të rehabilitojë kryerësin, dhe 2) të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale”. Duke e pasur parasysh këtë, trupi gjykues vendos si në vijim.

133. Duke u bazuar në atë që u tha më lart në kapitullin FI lidhur me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës nga data 01 janar 2013, dhe duke e pasur parasysh parimin e zbatimit të detyrueshëm të *lex mitior*²⁹, trupi gjykues

²⁹ *Shih rastin S. kundër I. nr.2*, nr. 10249/03, GjEDNJ;

duhet të marrë parasysh *in concreto* se cili ligj do të ishte më i favorshëm për të pandehurit gjatë llogaritjes së dënimit. Siç është theksuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), *lex mitior* është më i favorshëm për të pandehurin, duke i marrë parasysh karakteristikat e tij ose saj, natyrën e veprës penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale³⁰. Prandaj, *lex mitior* duhet të gjendet *in concreto*³¹.

I. Matja e dënimit sipas KPK-së të vjetër

134. Në lidhje me veprën penale 'Kontrabandim me migrantë, neni 138 paragrafi (6) i KPK-së parasheh dënimin me burgim prej **dy deri në dhjetë vjet**.

135. Sipas nenit 64 të KPK-së: "Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të parapare me ligj për atë vepër penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallen e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit".

136. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin B. G., trupi gjykues e ka konsideruar vetëm gjendjen e tij familjare.

³⁰ Shih rastin *S. kundër I.* (nr. 2), nr. 10249/03, par. 109, 17 shtator 2009; *M. dhe D. kundër B. dhe H.*, mendime të veçanta, faqe 43;

³¹ Shih më lart, *M. dhe D.c kundër B. dhe H.*, faqe 44;

137. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin H. A., trupi gjykues e ka konsideruar faktin se ai ka pasur rol të vogël në rrjetin e kontrabandimit dhe ai ka pasur vetëm pjesëmarrje materiale, përkatësisht atë të vozitësit.
138. Si rrethanë lehtësuese për të dy të pandehurit, trupi gjykues ka konsideruar periudhën e konsiderueshme kohore e cila ka kaluar që nga kryerja e veprave penale, gjë që e ka zvogëluar ndikimin e tyre shoqëror. Për të njëjtin qëllim, trupi gjykues ka konsideruar kohëzgjatjen e procedurës si rrethanë lehtësuese.
139. Si rrethanë rënduese për të dy të pandehurit, trupi gjykues e përfshin faktin që F. B. ka qenë i mitur në datën e kryerjes së veprës penale që e përfshinte atë.
140. Prandaj, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartpërmendura, trupi gjykues do të shqiptonte kundër të pandehurit B. G. dënimin prej katër (4) vjet burgim.
141. Ndërsa, trupi gjykues do të shqiptonte kundër të pandehurit H. A. dënimin prej dy (2) vjet e tre (3) muaj burgim.

II. Matja e dënimit sipas KPRK-së të ri

142. Në lidhje me veprën penale 'Kontrabandim me migrantë, neni 170 paragrafi (1) i KPRK-së të ri parasheh dënimin prej dy (2) deri dhjetë (10) vite burgim dhe gjobë. Paragrafi (6) i të njëjtit nen parasheh dënimin prej jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

143. Prandaj, shkalla e zbatueshme e dënimit është prej pesë (5) deri dhjetë (10) vjet burgim dhe gjobë.
144. Në bazë të rrethanave të njëjta lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues do të shqiptonte kundër të pandehurit B. G. dënimin prej gjashtë (6) vite burgim dhe gjobë prej njëqind (100) euro, dhe kundër të pandehurit H. A. dënimin prej pesë (5) vite e dy (2) muaj burgim dhe gjobë prej njëqind (100) euro.

III. *Lex mitior* dhe matja përfundimtare

145. Trupi gjykues konsideron se me zbatimin e KPK-së të vjetër do të arrihet *in concreto* rezultati më i favorshëm për të pandehurit.
146. Prandaj, në lidhje me të pandehurin B. G., trupi gjykues ka shqiptuar dënimin prej katër (4) vjet burgim për veprën penale ‘Kontrabandimi me migrantë’, në përputhje me nenet 38 (1) dhe 138 (6) të KPK-së.
147. Koha e kaluar në paraburgim prej 23 tetorit 2012 do të llogaritet në përputhje me nenin 73 paragrafin (1) të KPK-së.
148. Në lidhje me të pandehurin H. A., trupi gjykues shqipton dënimin e llogaritur prej dy (2) vjet dhe tre (3) muaj burgim për veprën penale ‘Kontrabandimi me migrantë’, në përputhje me nenet 38 (1) dhe 138 (6) të KPK-së.
149. Koha e kaluar në paraburgim prej 06 dhjetorit 2012 deri më 6 mars 2012 do të llogaritet në përputhje me nenin 73 paragrafin (1) të KPK-së.

H. SHPENZIMET E PROCEDURËS

150. Trupi gjykues gjen të pandehurit B. G. dhe H. A. fajtorë dhe, sipas nenit 453 paragrafit (1) të KPPK-së, secili do t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale. Duke e pasur parasysh numrin e seancave të mbajtura dhe gjendjen ekonomike të të akuzuarve, trupi gjykues vendos që secili i akuzuar do të kompensojë dyqind (200) euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, por ata lirohen nga obligimi i kompensimit të shpenzimeve të mbetura në përputhje me nenin 453 paragrafin (4) të KPPK-së.
151. Të akuzuarit do të kompensojnë shumën e urdhëruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita kur aktgjykimi bëhet i formës së prerë.

I. KËRKESA PASURORE JURIDIKE

152. Trupi gjykues vëren se palët e dëmtuara nuk kanë paraqitur kërkesë për kompensim gjatë periudhës së gjykimit.

Gjykata Themelore e Mitrovicës

Roxana Comsa

Rifat Bllata

Franciska Fiser

Kryetare e trupi gjykues

Anëtar i trupit gjykues

Anëtare e trupit gjykues

Chiara Tagliani

Procesmbajtëse

Përpiluar në gjuhën angleze, versioni origjinal

Mjeti juridik: I pandehuri, avokatët e tyre mbrojtës, prokurori, pala e dëmtuar ose përfaqësuesi i tyre i autorizuar kanë 15 ditë nga dorëzimi i këtij aktgjykimi për të paraqitur ankesë në pajtim me nenet 380(1) dhe 381(1) të KPP-së. Ankesa paraqitet në gjykatën e shkallës së parë sipas nenit 388(1) të KPP-së.